

**KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË  
PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË FERIZAJT**Nr. 01-94Datë: 26-04-2024

Në bazë të nenit 3 paragrafët 1 nën-paragrafët 2,3,11 neni 6 paragrafi 1 si dhe të nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 e datës 03 Prill 2019), për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 paragrafi 1 pika 1.3, neni 13, 14, 15 të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në zbatim të Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës 01. Nr. 72 të dt. 31.07.2023, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës, si dhe në zbatim të përgjegjësi sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01. Nr. 92, të dt. 29.09.2023, për themelimin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues në mbledhjen e mbajtur me datën 13.11.2023, vendos për shpalljen:

**NJOFTIM PËR SHPREHJEN E INTERESIT  
PËR MARRJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË, TË PRONËS SË KOMUNËS SË  
FERIZAJT**

Njoftimi publik për shprehjen e interesit zgjatë pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit dhe përfshinë;

**1. Pronën e cila ipet në shfrytëzim,**

Nr	Vendi i Dhënies në Shfrytëzim të Pronës	Adresa e Pronës	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
1	Pjesa e ngastrës kadastrale 626-2 Z.K. Babush i Ri	Fsh. Babiush i Ri- Magj. Ferizaj- Prishtinë	504 m <sup>2</sup>

- Afati për dhënie në shfrytëzim të pronës është 99 vite.
- Çmimi i përcaktuar është 100.00 € për një vit kalendarik, dhe fillon të faturohet nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Veprimtaria e cila mund të ushtrohet është Afarizëm/Tregti-Industri.
- Njoftimi për shprehje të interesit do të jetë i hapur nga data 26.04.2024 deri me datën 11.05.2024 ora 16.00.
- Vendi i dorëzimit të ofertave për shprehje të interesit duhet të bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetar, në zarf të bardhë, protokollohet si e tillë dhe duhet të shënohet numri i parcelës kadastrale për të cilën aplikohet.

## Kriteret për vlerësimin e ofertave

Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë,

- Vlera e investimit,
- Numri i të punësuarve nga investimi,
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën,
- Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës,

## Kritere shtesë janë;

- Vlera minimale e investimit duhet të jetë 50,000.00 €.
- Garancini Bankar për përmbushje të vlerës minimale në shumë prej 50,000.00 €.
- Garancioni duhet të jetë në kohëzgjatje të implementimit të projektit.

## Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve;

Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të paraqesin ofertat e tyre për marrjen e pronës së komunës në shfrytëzim afatgjatë, sipas njoftimit publik të shpallur nga komuna.

Pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë;

- Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit;
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

## Dokumentet e nevojshme për Aplikim;

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar;
- Letër njoftimi kopje;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit, (për subjekte juridike);
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK-së, (për bizneset vendore);
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës, Pagesa e Tatimit në Pronë
- Projektin – Planin e biznesit i cili përfshinë -vlera e investimit, numri i të punësuarve nga investimi, lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën, përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës.
- Garancionin Bankar në kohëzgjatje deri në përmbushje të projektit.

**Hapja e ofertave bëhet me datë 14.05.2024, në sallën e Kuvendit Komunal të Ferizajt nga ora 10:00.**

**Tërheqja e aplikacioneve-kopje fizike dhe elektronike, mund të bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Hyrje të Komunës së Ferizajt, çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 16.00.**

**Të interesuarit mund të informohen(çdo ditë pune) përmes:**

- Ueb faqes <http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>
- Telefonit: 038/200/46-076
- E-mail adresës: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

Kryesuesi i Komisioni Vlerësues i Ofertave

Sabri Murseli



Komuna: FERIZAJ  
Zona Kadastrale: Babush i Sërbye  
Drejt: për Pron, Gjeodezi dhe Kadasier  
-Sektor i Pronës

## SKICA E MATJES

Pa Përpjes



Ngjyra e verdhë tregon pjesën e ng.kad:626-2 me sip:504m<sup>2</sup> zk.Babush i Sërbye Komuna e Ferizajit  
Propozim Vendim për Dhenjen në shfrytëzim afatgjat

Ferizaj: 20.07.2023

Punoi Gjeodeti: *Mehmet Mehmeti*